



DREJTORIA E ARSIMIT
DIREKCIJA OBRAZOVANJA
DIRECTORATE OF EDUCATION

Tel: 038/200-46005
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

DATA/DATUM/DATE	13.01.2025
NR/ BR	07 Nr./ <u>24</u>
PËR/ZA/TO	Publikim të konkursit për mësimdhënës/e
PËRMES/PREKO/THROUGH	Sektorit të administratës së Drejtorisë së Arsimit
NGA/OD/FROM	Drejtori i Drejtorisë së Arsimit z.Afrim Llabjani
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Konkurs për mësimdhënës/e

Bazuar në nenin 08 të Ligjit të Punës 03/L-212, nenin 35 paragrafi 1,4 dhe 5 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës nr. 04/L-32, neni 5 pika c, i Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, Udhëzimeve Administrative të MASHTI-it, nr. 05/2021 dhe 05/2015, Normativi për Kuadrin e Arsimit të Përgjithshëm dhe Arsimit Professional të MASHTI-it, të Rregullores së (QRK) Nr:19/2024, e datës 24.07.2024, Drejtoria e Arsimit në Ferizaj shpall:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendeve të lira të punës në Shkollën të Mesme të Larta dhe Shkollën Filllore të Mesme të Ulëta.

Mësimdhënës/e për Lëndën e Matematikës për 20 orë, zëvendësim në Shkollën "Elena Gjika", në Ferizaj.

Numri i Pozitave: një (1).

Koeficienti: 5.8

Mësimdhënës/e për Lëndën e Kimisë për 20 orë, zëvendësim në Shkollën "Elena Gjika", në Ferizaj.

Numri i Pozitave: një (1).

Koeficienti: 5.8

Mësimdhënës/e për Lëndë Ekonomike për 10 orë në Shkollën "Faik Konica" dhe 6 orë, në zëvendësim në Shkollën "Elena Gjika", në Ferizaj.

Numri i Pozitave: një (1).

Koeficienti: 5.8

Mësimdhënës/e për Lëndën e Matematikës për 12 orë, me kohë të caktuar deri me 30.06.2025 në Shkollën “ Imri Halili ”, në Fshatin Gaçkë dhe 8 orë në Fshatin Greme, Komuna e Ferizajt.

Numri i Pozitave: një (1).

Koeficienti: 5.6

Mësimdhënës/e për Lëndën e Muzikës për 12 orë, me kohë të caktuar deri me 30.06.2025, në Shkollën “ Naim Frashëri ”, në Fshatin Zaskok, Komuna e Ferizajt.

Numri i Pozitave: një (1).

Koeficienti: 5.6

Mësimdhënës/e për Lëndën e Gjeografisë për 12 orë, në zëvendësim në Shkollën “ Ali Hadri ”, në Fshatin Mirash, dhe 7 orë në Shkollën “ Skenderbeu” në Fshatin Jezerc, Komuna e Ferizajt.

Numri i Pozitave: një (1).

Koeficienti: 5.6

Mësimdhënës/e për Lëndën e Artit Figurativ për 12 orë, në zëvendësim në Shkollën “ Abetarja ”, në Fshatin Softaj, Komuna e Ferizajt.

Numri i Pozitave: një (1).

Koeficienti: 5.6

Lloji i Pozitave: Nëpunës të Shërbimit Publik;

Titulli i mbikëqyrësit: Drejtori i institucionit;

Detyrat dhe përgjegjësitë për Mësimdhënës/e

1. Punë kryesi është i obliguar ta realizojë plan programin mësimor për vendin përkatës të punësduke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/saj të punës;
2. Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies;
3. Të përgatisë me rregull planin mësimor vjetor, mujor dhe ditor, në përputhje me korrikulën, e në pajtim me kërkesat për përshatjen e mësimdhënies, aftësive dhe prirjeve individuale të çdo nxënësi;
4. Të ketë njohuri për një repertor të gjerë të stileve mësimore dhe të jetë në gjendje ti aplikojë ato që më së miri i përgjigjen situatës në klasë;
5. T'i shfrytëzoj në mënyrë efektive resurset që i ka në dispozicion;
6. Të planifikoj, të udhëheqë dhe të vëzhgoj nxënien dhe sjelljen e secilit nxënës;
7. Të zbatoj metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet kurrikulare;

8. Të krijojë një atmosferë pune dhe disipline, pa përdorur metoda ndëshkimi ose forma të ndryshme të poshtërimit ndaj nxënësve;
9. Të kontrolloj me rregull dhe të mbajë evidencë për suksesin dhe progresin individual të secilit nxënës si dhe të jetë në gjendje t'i raportoj prindit apo kujdestarit të fëmijës drejt për progresin e arritur të nxënësit sipas kërkesës;
10. Të zgjoj të nxënësit kureshtjen për të nxënë dhe ti inkuadrojë ata të nxënë në mënyrë të pavarur;
11. Të kujdeset për zhvillim të vazhdueshëm profesional individual sipas planit të paraparë dhe të kujdeset për realizimin e planifikimit;
12. Të jetë në komunikim të vazhdueshëm me familjen e çdo nxënësi duke realizuar takime individuale me prindër, kujdestarë të fëmijës;
13. T'i ndihmojë kolegët për ngritjen e cilësisë së punës;
14. Të mbikëqyrë dhe të udhëzoj nxënësit në procesin mësimor;
15. Të marrë pjesë në punën e organeve të shkollës;
16. Të marrë pjesë aktive në përgatitjen e programeve dhe evenimenteve në shkollë, kur kërkohet nga drejtori i shkollës;
17. Të marrë pjesë në formë aktive në organizimet jashtë mësimore me nxënës dhe të kryejë me përgjegjësi ekskursionet me nxënës brenda dhe jashtë vendit, sipas udhëzimeve të drejtorit të shkollës;
18. Të tregoj respekt sjellje kolegjiale dhe jo diskriminuese ndaj bashkëpunëtorëve me të cilët punon;
19. Të respektoj autoritetin e drejtpërdrejt të zyrtarit të cilit i raporton, dhe t'i kryej detyrat që mund t'i caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi;
20. Të mos kërkojë apo të pranojë udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç drejtorit të shkollës dhe DKA-së ose personave të caktuar nga ata;
21. Të mos e shfrytëzoj pozitën e punës për interesa private në dobi të një pale të tretë, përfshirë edhe familjen, shoqërinë apo rrethin shoqëror;
22. Të ushtrojë maturi maksimale lidhur me të gjitha çështjet e punës. Përfshirë ruajtjen e informatave (nëse nuk janë publike), të cilat lidhen me procesin e punës dhe raporteve të krijuara prej saj, duke mos komunikuar këto informata me asnjë person fizik dhe juridik, përveç kur informatat e tilla janë të parapara në kuadër të detyrave sipas kësaj kontrate apo autorizimit nga zyrtari të cilit i raporton;
23. Të mbajë orën e kujdestarisë dhe kujdestarinë ditore;
24. I punësuar i është i obliguar të respektoj kodin e veshjes dhe të sjelljes, të përcaktuara me rregulloren e brendshme të shkollës dhe me akte tjera nënligjore;
25. I punësuar i, nuk do të kryej punë apo detyrë tjetër, me orar të plotë, nëse puna e tillë, bie ndesh me aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga DKA-ja ose përfaqësuesit e saj;

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin e zyrtarëve publikë

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prërë për kryerjen e një veprë penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik.
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Për vendin e punës për mësimdhënës/e kërkohet përgatitja përkatëse profesionale sipas Udhëzimeve Administrative të MASHTI-it, nr. 05/2021 dhe 05/2015, Normativi për Kuadrin e Arsimit të Përgjithshëm dhe Arsimit Professional të MASHTI-it,

Të drejtë aplikimi kanë kandidatët me përgatitje profesionale përkatëse.

- **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e të Matematikës në SHML dhe SHFMU**
 Niveli master arsimor- Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
 Sistemi katërvjeçar
 Baçelor katërvjeçar (240 ECTS)
 Në mungesë të kandidatëve me përgatitje të tillë mund të aplikojnë edhe kandidatë me kualifikim trevjeçar me (180 ECTS), për një vit shkollor.

- **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e të Kimisë në SHML**
 Niveli master arsimor- Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
 Sistemi katërvjeçar
 Baçelor katërvjeçar (240 ECTS)
 Në mungesë të kandidatëve me përgatitje të tillë mund të aplikojnë edhe kandidatë me kualifikim trevjeçar me (180 ECTS), për një vit shkollor.

- **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e të Lëndëve Ekonomike në SHML**
 MSc. i ekonomisë- profilit përkatës
 Ekonomist i diplomuar banka, financa, kontabilitet
 Ekonomist i diplomuar përgjithshëm
 Në mungesë të kandidatëve me përgatitje të tillë mund të aplikojnë edhe kandidatë me kualifikim trevjeçar me (180 ECTS), për një vit shkollor.

- **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e të Muzikës në SHFMU**
 Niveli master pedagogji e përgjithshme muzikore (300 ECTS)
 Sistemi katërvjeçar
 Baçelor katërvjeçar pedagogji e përgjithshme muzikore (240 ECTS)
 Në mungesë të kandidatëve me përgatitje të tillë mund të aplikojnë edhe kandidatë me kualifikim trevjeçar me (180 ECTS), për një vit shkollor.

- **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e të Gjeografisë në SHFMU**
 Niveli master arsimor- Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
 Sistemi katërvjeçar
 Baçelor katërvjeçar (240 ECTS)
 Në mungesë të kandidatëve me përgatitje të tillë mund të aplikojnë edhe kandidatë me kualifikim trevjeçar me (180 ECTS), për një vit shkollor.

- **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e të Artit Figurativ në SHFMU**
 Niveli master arsimor- (300 ECTS)
 Sistemi katërvjeçar
 Baçelor katërvjeçar (240 ECTS)
 Në mungesë të kandidatëve me përgatitje të tillë mund të aplikojnë edhe kandidatë me kualifikim trevjeçar me (180 ECTS), për një vit shkollor.

Aplikacionet merren në zyrën për shërbimin e qytetarëve, për Drejtorinë e Arsimit.

Për aplikim kandidatët duhet të kompletojnë dokumentacionin në vijim:

Aplikacionin për pozitën e punës të plotësuar;

Diplomën ose Certifikatën e fakultetit, kopje e vërtetuar, (kandidatët që kanë përfunduar master duhet ta kenë edhe diplomën e bachelorit).

Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës, duhet të kenë vendim për njohje nga MASHTI, për diplomat e tyre;

Dokumenti personal kopje, letërnjoftimin ose pasaportën valide;

Rezymeja personale (CV);

Certifikatën nga Gjykata që nuk është nën hetime (origjinali);

Vërtetimin e përvojës së punës në mësimdhënie, nëse aplikuesi ka përvojë pune;

Kandidatët që kanë përvojë pune dorëzojnë edhe portfolio profesionale me përmbledhjen e punës së tyre;

Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni.

Dokumentet e aplikimit nuk kthehen.

Dokumente që nuk kërkohen gjatë aplikimit, por në fazën para emërimit:

Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore.

Dëshmi se kandidati ka zotësi të plotë të veprimit, (duhet të sillen para nënshkrimit të kontratës së punës).

Aplikimi bëhet në formë elektronike me dokumente të skanuara në programin PDF në emailin adresën: drejtoriaearsimit.ferizaj@gmail.com konkursi mbetet i hapur 7 ditë pune dhe fillon nga data 13.01.2025- dhe mbyllet në ora 16-të 21.01.2025.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët fitojnë të drejtën për intervistë me shkrim.

Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, e fitojnë të drejtën për intervistë me gojë. Në intervistën me gojë, kandidatët mund të vlerësohen deri në 50% të vlerësimit përfundimtar.

Lista e ngushtë e kandidatëve që ftohen për intervistë me shkrim dhe intervistë me gojë, orari intervistave dhe rezultatet përfundimtare të vlerësimit, publikohen në tabelën e shpalljeve dhe në web faqen e komunës së Ferizajt, në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/>.